



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 115/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Hasan Shala dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, për shkak të veprimeve provokuese, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV)

Arsyetim

PZAP-i, me datën 03.06.2014 ka pranuar një ankesë nga LVV dega Prishtinë në të cilën theksohet se me datën 02.06.2014 në rrugën UÇK rrespektivisht përpara ndërtesës së LVV-së aktivistët e subjektit politik LDK ishin ndaluar përpara ndërtesës së LVV-së me një furgon të bardhë me targa 04-605-BK e ku njëri nga aktivistët kishte dalur nga automjeti dhe së bashku me të tjerët kishte filluar të brohoriste dhe të provokonte “Jeni në opozitë” dhe duke drejtuar me gishtërinjë në drejtim të aktivistëve të LVV-së që ishin në katin e poshtëm të objektit. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime të aktivistëve të LDK-së janë në kundërshtim me Rregullat Zgjedhore të KQZ-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi disa fotografi nga vendi i pretenduar i ngjarjes.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.06.2014, në ora 09:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK në të cilën deklaroi se fotot e bashkangjitura si provë në asnjë mënyrë nuk dëshmojnë se personat në fjalë janë aktivistë të LDK-së, supozimi se i kanë ngritur gishtërinjtë në drejtim të selisë së LVV-së nuk qendron pasi që personi në foto as që është i kthyer nga selia e LVV-së, fototo nuk dëshmojnë brohoritjet e theksuara në ankesë dhe se furgoni në fjalë nuk është i ndaluar para selisë së LVV-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të LVV-së janë të pabazuara pasi që nga fotografit dhe video inçizimi i ofruar si dëshmi nuk mund të vërtetohet për asnjë moment pretendimi i tillë për të cilin pretendohet në ankesë, andaj një ankesë e tillë është e pabazë dhe pa asnjë provë bindëse që do ta vërtetonte atë për të cilin pretendohet në ankesë. PZAP-i në mungesë të provave lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë konstatoi se një ankesë e tillë është e përgjithshëm dhe e pa bazuar me prova dhe me dëshmi bindëse dhe konkrete, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 115/2014 më datën 05.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*